



Problema me 3 pikë

1. Cili numër ndodhet brenda trekëndëshit, katrorit dhe rrethit?




- (A) 1 (B) 4 (C) 5 (D) 9 (E) 12

2. Mbi dy katrorë xhami janë vizatuar disa forma. Ana i vendosi copat njëra mbi tjetrën, pa i rrotulluar. Cila është pamja që sheh ajo?



- (A) (B) (C) (D) (E)


3. Bruno po krijon një trekëndësh të madh, duke përdorur trekëndësha të vegjël të njëjtë.




Sa trekëndësha të tjerë të vegjël i nevojiten Brunos për të plotësuar trekëndëshin e madh?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7


4. Kanguri Kevin vendos një figurë në tabelë




Ai e rrotullon figurën me një çerek rrotullimi, siç tregohet më lartë. Çfarë sheh Kevin pas përfundimit të rrotullimeve?





5. Në figurë janë paraqitur 8 fytyra të ndryshme




Çdo fytyrë shfaqet dy herë, përveç njërës. Cila është ajo?



6. Figura paraqet 4 forma të çuditshme. Sa forma kanë 3 pika brenda vetes?



7. Çdo numër më poshtë është krijuar duke përdorur një copë fjongoje.








Cila nga copat e fjongove është më e gjata?

- (A) 1 (B) 2 (C) 5 (D) 6
 (E) Të gjitha ato kanë të njëjtën gjatësi.


8. Elena përdor vulën e treguar për të krijuar një figurë. Cilën figurë krijoi ajo?




- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

Problema me 4 pikë

9. Amari ka 5 shporta, secila përmban 4 lodra.




Ai zbrazi 4 prej shportave dhe lodrat e tyre i përzieu bashkë.








Cila nga shportat mbeti pa u përzier?

- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


10. Një nxënës ka 4 blloqe, siç tregohet më poshtë.



Cila prej formave të mëposhtme nuk mund ndërtohet duke përdorur këto 4 blloqe?



11. Në diagramën e mëposhtme, çdo formë paraqet një vlerë të ndryshme.



Cila është vlera e ?

(A) 2


(B) 3

(C) 4




(D) 5

(E) 6


12. Kaltra dëshiron që të ecë përmes labirintit, në mënyrë që të vizitojë vetëm dhomat ku shuma është 7.



Në cilin frut arrin Kaltra?




13. Një kal lodër ndodhet brenda një kutie që është 1 metër e lartë, 1 metër e gjerë dhe 2 metra e gjatë.



Kutia është e mbështjellë me një fjongo, siç paraqitet në figurë. Nyja kërkon një metër më shumë fjongo. Sa e gjatë është në total fjongoja?


- (A) 9 metra (B) 11 metra (C) 13 metra (D) 15 metra (E) 17 metra

14. Shuma e numrave brenda trekëndëshit duhet të jetë sa dyfishi i shumës së numrave brenda rrethit.








Cili numër duhet të vendoset në shenjën e pikëpyetjes?

- (A) 3 (B) 5 (C) 8 (D) 11 (E) 16


15. Një rresht me figura krijohet duke përsëritur këtë model prej 5 figurash  gjithmonë në të njëjtën radhitje.



Cila figurë është në pozicionin e 27-të të rreshtit?

- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 


16. Një nga numrat në figurë është sa shuma e numrave të lidhur drejtpërdrejtë me të. Cili është ky numër?




- (A) 3 (B) 5 (C) 7 (D) 10 (E) 12

Problema me 5 pikë


17. Kaltrina ka një kuti transparente që përmban 6 kube të vegjël, siç tregohet më poshtë.



Cila është pamja që sheh Kaltrina nëse ajo e shikon kutinë nga lart?




18. Enio do të zgjedhë dy numra nga dërrasa dhe t'i mbledhë ata së bashku.



Sa rezultate të ndryshme merr Enio?


- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 10

19. Cila prej pjesëve mund të përdoren për të plotësuar katrorin pa mbivendosje?



- (A) 1 dhe 2 (B) 1 dhe 3 (C) 3 dhe 4 (D) 2 dhe 4 (E) 2 dhe 3


20. Saimiri ndërton kulla me tri lloje blloqesh. Lartësitë e tre prej tyre janë paraqitur në figurë




Cila është lartësia e kullës së katërt?

- (A) 12 (B) 13 (C) 14 (D) 16 (E) 17


21. Arbeni, Blerta, Joni dhe Diori kanë 3 forma secili. Çdo fëmijë ka saktësisht një formë të përbashkët me çdo fëmijë tjetër.



Cilat forma ka Diori?



22. Zana do të lëvizë përmes rrjetës nga hyrja A te dalja B . Ajo mund të lëvizë vetëm në të djathtë dhe lart. Sa herë që viziton një kuti gri, ajo duhet të paguajë 1 lek. Sa herë që viziton një kuti të bardhë ajo duhet të paguajë 2 lekë. Sa lekë duhet të paguajë ajo për rrugën më të lirë?



- (A) 11 lekë (B) 12 lekë (C) 13 lekë
 (D) 15 lekë (E) 16 lekë

23. Jetmira ka një listë me probleme për të përfunduar përgjatë muajit maj. Ajo nis në datën 1 maj.

Nëse ajo zgjidh saktësisht 2 probleme çdo ditë, ajo do ta përfundojë detyrën të dielën. Nëse ajo zgjidh saktësisht 3 probleme çdo ditë, ajo do ta përfundojë detyrën të mërkurën. Sa probleme janë në listë?

- (A) 6 (B) 12 (C) 18 (D) 24 (E) 30

24. Andrea po qëllonte me shigjeta një tabelë. Ai nisi me 10 shigjeta dhe merrte 2 shigjeta të reja sa herë që godiste tabelën. Në total, Andrea hodhi 20 shigjeta dhe nuk i mbetën më shigjeta. Sa herë e goditi Andrea tabelën?

- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 8 (E) 10